

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikës shndërrohet në leksione gjeopolitike
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/berisha-ne-nju-jork-kur-nje-vakt-me-shqiptaret-e-amerikes-shnderrohet-n-i584253
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 09:57:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 10:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b65d1773ac3a31842b115015e2086e7a3d1afca30791077e7c63e0c69c41742d
TEKSTI	d39d338beeca88c16f2180edccdd93c3e0f1eb4199e69e2b2d91068c5c3d4e29
PAMJA	c55ec745e31d2c43629a18c9c376cd347f59b722ce5ad7b644f9d74466b01bdf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72dc9d3d0903865cdb4f345ce7c711dce54d533d961b39fc05a1eee281b60aa6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9a9ddfab3524b675296de199d2c84d7912efeec093d45c9244538a4c87c79b0
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmVa46jty6DHo2iWR4H3GpifXzRT5LfxnJJ5QjG31hJmju



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72dc9d3d0903865cdb4f345ce7c711dce54d533d961b39fc05a1eee281b60aa6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Kreu disa vjedhje ne Shkoder, arrestohet 20-vjeçari! Dyshohet se bashkepunonte me nje te miturZjarret ne vend/ /35 torca dhe 64 zjarrhese ne terren, angazhohen edhe fundit

Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikës shndërrohet në leksione gjeopolitike



6 Shtator 2026, 12:15Politika TEMA



Sali Berisha ka gjetur në Nju Jork skenën e radhës për të bërë atë që di më mirë: të ulët në një tavolinë me shqiptarë, të marrë mikrofonin dhe ta kthejë vaktin në leksion për Shqipërinë, Amerikën, Meksikën, krimin, drogën, dollarin, euron dhe fatin ekzistencial të kombit.

Në pamje të parë, ishte një takim me diasporën. Në thelb, një nga ato skenat ku politika shqiptare merr formën më të njohur: disa njerëz të ulur për të ngrënë, një lider në krye të tryezës dhe një ligjëratë që nis me Shqipërinë, kalon nga kartelet e Meksikës dhe përfundon te misioni historik i emigrantëve.

Berisha foli për shpopullimin, për drogën, për zhvlerësimin e euros e dollarit, për falimentimin e bizneseve, për “çifligun e një njeriu” dhe për një regjim që sipas tij po e gërryen Shqipërinë nga brenda. Në një moment, Shqipëria u krahasua edhe me Meksikën, ku sipas Berishës efekti i parave të pista në ekonomi është më i vogël se në vendin tonë.

Pra, shqiptarët në Nju Jork kishin dalë për një takim, ndoshta edhe për një vakt, por përfunduan në një kurs të përshpejtuar mbi gjeopolitikën e krimin, ekonominë informale, remitancat, narkotrafikun dhe historinë e platformave të shpopullimit. Nga pjata te Çubrilloviçi, nga dollari te droga, nga diaspora te shpëtimi kombëtar.

Ironia është se Berisha, i cili prej vitesh është vetë një nga figurat më të gjata dhe më të diskutueshme të tranzicionit shqiptar, u foli shqiptarëve të larguar për dramën e largimit nga Shqipëria. Sikur shpopullimi të ketë nisur dje. Sikur vendi të jetë zbrazur vetëm nga qeverisja e Ramës dhe jo nga një sistem politik ku Berisha ka qenë jo spektator, por aktor kryesor për më shumë se tri dekada.

Në fjalën e tij, kreu i PD-së e paraqiti diasporën si shpresën e fundit për të shpëtuar Shqipërinë nga kapja e shtetit, propaganda dhe krimi i organizuar. Dhe këtu tabloja bëhet edhe më cinike: politika që për vite i ka larguar shqiptarët nga vendi, tani u kërkon atyre, nga larg, të shpëtojnë vendin që vetë nuk arriti ta bëjë të jetueshëm. /VNA



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama përballë 300 pyetjeve, nga Sazani te SPAK dhe pasardhësi: Nuk kam ndërmend ta zgjedh](#)

08:45 Politika / 23 komente

[Shkon për vetulla, por gjen protesta - Meçe: Sali Berishës nuk i është hequr "non grata", është ftuar nga të tjerë](#)

20:55 Politika / 14 komente

[Braçe shpërthen ndaj piromanëve: Edhe të djegura, sipërfaqet mbeten fond pyjor, nuk bëhen hotele e resorte](#)

20:45 Politika / 8 komente

[Sesion i ri, beteja të vjetra! Kuvendi rikthehet më 8 shtator, PS përgatit hartën me 46 bashki, PD paralajmëron betejë në Kushtetuese](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.